



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**

**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**PA1 Nr. 03-76**

**24.02.2023**

**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe nenit 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark. nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-465 /1 datë 27.1.2023 dhe Konkluzioni ark.nr.02-824/2 datë 23.2.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 7-të mbajtur më 23.2.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim  
për ndërmarrje të masës - vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, për shkeljen e kryer të nenit 51 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), në mënyrë që transmetuesi në kuadër të shërbimit televiziv të transmetuar më 4 janar 2023 nuk ka ofruar informacionin që duhet të vihet në dispozicion të shfrytëzuesve.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me ark.nr.10-465/1 datë 27.1.2023, si pjesë përbërëse i këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP, Kumanovë, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimit llogaritet dita e vërtetimit të tij në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrjen administrative të punës së botuesve të mediave në aspektin e pajtueshmërisë së punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, LSHMAAV dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet të tjera të Agjencisë.

Në pikën 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, përcaktohet se për shkeljet e konstatuara në vitin aktual, për të cilat janë

shqiptur masa në vitin paraprak, Këshilli i Agjencia sërish do të shqipton masë vërejtje publike sipas afateve të përcaktuara në Udhëzim.

Në pajtim me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale duhet t'u ofrojnë shfrytëzuesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme të paktën për të dhënat e mëposhtme: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel, përkatësisht emërtimin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar të identifikimit (avizo, logo dhe të ngjajshme); adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel; të dhëna për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio ose audiovizuel (numri i telefonit, adresa e postës elektronike dhe/ose uebfaqja, personi kontaktues për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundur, dhe të organit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 27 janar 2023, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, transmetuar më 4 janar 2023, në nivel lokal, në të cilin ka konstatuar shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV. Gjegjësisht, me mbikëqyrje është konstatuar se transmetuesi dhe përkundër Aktvendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike (PA1 nr. 03-354) miratuar më 29.11.2022, nuk e ka mënjanuar shkeljen, gjegjësisht ka vazhduar të kryej të njëjtën shkelje të LSHMAAV.

Në kundërshtim me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, shërbimi programor televiziv i SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion shfrytëzuesve (përdoruesve), gjegjësisht nuk u mundësoi përdoruesve të tij qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme të paktën në të dhënat e mëposhtme: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual; adresën e selisë së ofruesit të shërbimit audiovizual; të dhëna për kontakt (numër telefonit, adresa e emailit dhe/ose adresa e uebfaqes; personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me nr.ark.10-465/1 datë 27.1.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në bazë të nenit 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP, Kumanovë me datë 30.1.2023, ka dërguar Shkresë me nr.ark.10-465/2 datë 30.1.2023, me të cilën i ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-465/1, datë 27.1.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Në afatin e paraparë SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 23.2.2020, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi se ndaj SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP, Kumanovë t'i shqiptoj masë – vërejtje publike .

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) të Ligjit të njëjtë, pikat 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-465 /1 datë 27.1.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-824/2 datë 23.2.2023, pasi u konstatua mosrespektim i dispozitave të LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 23.2.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP, Kumanovë dhe detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas vendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia

për ngritjen e kontestit administrative paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-465 /1 datë 27.1.2023

**Agjencia për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI d.v**

**Udhëzim ligjor:** Kundër këtij vendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

**Dorëzuar tek:**

- SHTR TV KANAL FESTA SHPK, Kumanovë;
- Drejtuesit të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP, Kumanovë;
- Personit përgjegjës të programit në SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP, Kumanovë ;
- Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike;
- Sektorit për çështje programore ; dhe
- Personat e emëruar në Agjencinë për udhëheqjen e regjistrimit PA1.